



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Arsim për punësim

(Pasqyrë e punës së AAAPARr-së gjatë vitit 2019)



Prishtinë, 2019



Arsimpër punësim

(Pasqyrë e punës së AAAPARr-së gjatë vitit 2019)



Përgatitur për botim nga:
Stafi i AAAPARr-së

Botues:

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr)
Ndërtesa: MAShT, II, pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik, kati III
Rr. "Agim Ramadani", p. n., Prishtinë

Përmbajtje

Investimi për të ardhmen	6
Hyrje.....	10
Implementimi i nivelit V.....	11
Vazhdohet edhe me gjeneratën e tretë.....	13
Diplomon gjenerata e parë për “Këshilltar kariere” në nivelin V të kualifikimit	13
Tre udhëzues të ri	15
Arsimi profesional, një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit.....	16
Mbahet Panairi i Edukimit.....	18
Shkollat e AAAPARr-së, të parat në procesin e validimit dhe akreditimit	20
Katër standarde të profesionit të zhvilluara	21
Inaugurohen tri qendra për karrierë.....	22
Inaugurimi i Qendrës së Karrierës në Qendrën e Kompetencës në Malishevë	23
Inaugurimi i Qendrës së Karrierës në ShMLT “11 Marsi” në Prizren	23
Inaugurimi i Qendrës së Karrierës në ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë.....	24
Vizitat zyrtare.....	25
Ndërtimi i urave për arsimin e të rriturve.....	25
Iniciativa e trajnimit dhe njohja e kompetencave	26
Autonomia dhe përgjegjësia arsimore.....	27
Bashkëpunimi për AAP.....	28
Vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut.....	28
Vizitë në Qendrën për Arsimin e të Rriturve	29
Vizitë në Qendrën për Arsim Profesional dhe trajnime	30
Vizitë në Shkollën e Mesme Profesionale “Boro Petroshevski”, Shkup	30
Vizitë në Athinë.....	31
Marrëveshjet e bashkëpunimit.....	33
Pjesëmarrja në Panairin e Edukimit.....	33
Qendra për Karrierë në Shkollë do të themelohet edhe në shkollat e AAAPARr-së	34
Marrëveshja me APPK-në	35
Zhvillimi i dy standardeve	35
Marrëveshje me D&DBusiness Support Center	35
Marrëveshje me Finlandën	36
Marrëveshje me Lux/Dev.....	37
Marrëveshje me Smart Bits	37

Marrëveshje me ALLED 2	38
Trajnimet.....	39
Trajnimi për “Smart Home”	Error! Bookmark not defined.
Trajnimi për stafin e Qendrave për Karrierë.....	Error! Bookmark not defined.
Trajnimi për udhëheqje arsimore	Error! Bookmark not defined.
Vlerësohet bashkëpunimi me shkollat.....	41
Konferenca e katërt vjetore “Arsim për punësim”	42
SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE.....	47
1.1. Qeverisja dhe legjislacioni	47
1.1.1. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore.....	47
1.1.2. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Financave.....	49



Fikrije Zymeri
u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së

Investimi për të ardhmen

Investimi në arsimin profesional padyshim është investim në të ardhmen duke pasur parasysh se është thelbësor për punësimin dhe përparimin e përgjithshëm shoqëror. Arsimi cilësor profesional mundëson krijimin e një force punëtore produktive e cila kontribuon në rritjen ekonomike dhe zhvillimin kombëtar.

Duke u mbështetur në nenin 13 dhe 34 të Ligjit Nr.04/L-138, për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, të vitit 2013, bazuar në Planin Strategjik të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës 2017-2021, në UA 14/14 dhe UA 05/12, Ligjit të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016, 2017 dhe 2018 dhe 2019 janë siguruar mjetet financiare për funksionimin e këtij institucioni dhe është trajnuar, licencuar e certifikuar stafi për aktivitete profesionale pedagogjike dhe financiare.

Kosova synon të integrohet në Bashkimin Evropian dhe në tregjet globale, prandaj duhet fuqizuar rolin dhe funksionimin e AAAPARr-së, duke koordinuar të gjitha nismat për reformimin në AAP, duke marrë në konsideratë parime të rëndësishme, si dimensionin evropian, transparencën, të nxënimit gjatë gjithë jetës, gjithëpërfshirjen dhe fleksibilitetin, rëndësinë etj., si dhe bashkëpunimin në partneritet të ngushtë me të gjithë bartësit relevantë të AAP-së.

Zhvillimi i burimeve njerëzore duhet parë në dy këndvështrime: sasi dhe cilësi. Për këtë rëndësi merr rekrutimi dhe trajnimi i personave të angazhuar për këtë qëllim;

-Shkallë dëshirës dhe vullnetit për reformim në AAP me Agjencinë gjithnjë e më tepër është më reale.

AAAPARr gjatë kohës së menaxhimit të jashtë shkollave partnere ka ndërmarrë një varg masash në drejtim të mbështetjes së tyre nëpërmjet krijimit të kushteve më të mira si në aspektin e forcimit të punëve menaxheriale, po ashtu edhe në drejtim të mbështetjes në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Ky fakt ka ndikuar në përmirësimin e kushteve të mësimin duke sjellë rezultate në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kështu, në këto vite të dhënat e krahasuara nëpër shkollat tona partnere tregojnë se në përgjithësi kemi të bëjmë me rritje sasiore dhe cilësore në numrin e nxënësve dhe të arriturat

e tyre. Mësimdhënësit, gjithashtu, kanë pasur rastin t'i nënshtrohen një numri trajnimesh si në aspektin pedagogjik, po ashtu edhe në aspektin profesional sipas profileve ku ata japin kontributin e tyre. Me funksionimin e AAAPARr-së gjatë këtyre pesë vjetëve janë arritur rezultate për përmirësimin e cilësisë në shkollat partnere nëpërmjet aktiviteteve të realizuara si më poshtë:

- Përgatitjene procedurave për akreditim të QeK;
- Analizimin dhe hulumtimin gjendjes së shkollave lidhur me regjistrimin e nxënësve, punësimin, braktisjen dhe orientimin në arsim të lartë;
- Analizimin e profileve nëpër shkolla profesionale në raport me emërtimet e profesioneve nga lista ekzistuese e klasifikimit të profesioneve me qëllim të unifikimit me listën e re të klasifikimit të profesioneve;
- Përshtatjen e planeve zhvillimore të shkollave konform kurikulës dhe nevojave të tregut të punës;
- Përgatitjen e projektpropozimeve nga shkollat për pjesëmarrje në institucione relevante ndërkombëtare mbështetëse të AAP-së;
- Hapjen dhe funksionimin e Qendrave të Karrierës;
- Zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Zhvillimin e standardeve të profesioneve për nivelin 3,4 dhe 5 sipas KKK-së;
- Zbatimin e nivelit të pestë të kualifikimeve BTEC në shkollat partnere për: “Asistent për nxënësit/fëmijët me nevoja të veçanta” dhe “Këshilltar për karrierë”;
- Zhvillimin e materialeve mësimore;
- Zhvillimin e udhëzuesve;
- Pjesëmarrjen dhe promovimin e shkollave profesionale si (“Dyert e hapura”);
- Ngritjen e kapaciteteve të stafit të Agjencisë sipas planit vjetor për trajnime nga Instituti për Administratë Publike (IKAP);
- Bashkëpunimin shkollë/ndërmarrje;
- Zhvillimin e kapaciteteve për menaxhimin e shkollave;
- Avancimin në përgatitjen e shkollave për menaxhimin e financave dhe personelit për bartjen graduale të këtyre kompetencave;
- Metodologjinë e mësimdhënies;
- Bazën e të dhënave- mini SMIA (krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të të dhënave për nxënësit, staf, menaxhimin dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit brenda shkollës dhe AAAPA dhe punësimi i të diplomuarve);
- Bashkëpunimi ndërkombëtar etj.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të të Rriturve (AAAPARr) si institucion i ri në bashkëpunim me partnerët relevantë ka analizuar situatën e tanishme të legjislacionit dhe politikave të AAP, sfidat të cilat kanë ndikim në funksionimin e AAP në Republikën e Kosovës dhe ka bërë identifikimin e nevojave për aktivitetet që kërkohen të ndërmerren për mundësitë e zgjidhjes së sfidave në të ardhmen e afërt si më poshtë:

1. Vendosjen e një mekanizmi adekuat për mbledhjen e fondeve;
2. QK dhe shkollat duhet ta përmirësojnë gjenerimin e të hyrave;
3. Partnerët socialë duhet të përfshihen në sistemin e AAP;


4. Në QK dhe shkollat partnere si dhe në shkollat e tjera profesionale duhet të punësohen mësimdhënës dhe instruktorë kompetentë;
5. Fleksibilitet i trajnimeve të ofruara nga QK dhe shkollat e AAP-së.

Duke pasur parasysh praktikat krahasuese për numrin e personelit të Agjencive të tilla ne kemi realizuar disa vizita studimore në rajon dhe duke u mbështetur te praktikat tek Qendra e AAP në Maqedoni (e cila funksionon si Agjenci e AAP) ka të punësuar momentalisht 20 persona, por numri i përgjithshëm i personelit sipas ligjit duhet të jetë 48, dhe stafi ekzistues i cili përfshin 11 specialistë të AAP-së me përvojë të gjatë nuk është në gjendje t'i kryejë përgjegjësitë e tyre me numrin aktual të personelit. Në Maqedoni ekziston një qendër e ndarë për arsimin e të rriturve. Në Slloveni janë të punësuar në AAP 46 persona, në Kroaci 82 ekspertë dhe në Mal të Zi 27. Praktikrat janë të ngjashme. Po ashtu, edhe Agjencia e AAP në Shqipëri momentalisht ka 16 anëtarë të personelit, në pritje që ky numër të rritet në 21, por kompetencat e tyre janë mjaft të kufizuara në krahasim me kompetencat e përshkruara më lart.

Edhe në Kosovë numri i personelit për Zyrën Qendrore në Agjencinë e AAP duhet të rritet nëse Agjencia merr përsipër përgjegjësitë për gjithë sistemin e AAP-së sipas nenit 13 të Ligjit të AAP-së, duke inkorporuar edhe përgjegjësitë për arsimin e të rriturve/mësimin gjatë gjithë jetës.

Megjithatë, mund të argumentohet fakti se Agjencia e AAPARr-së duke pasur vetëm tetë të punësuar në Zyrën Qendrore, për ta plotësuar këtë zbrazëti ka angazhuar ekspertë të fushës profesionale dhe financiare sidhe mësimdhënës/ekspertë nga shkollat partnere në mënyrë që të kompensohet mungesa e kuadrove. Prandaj, kompletimi i personelit në Zyrën Qendrore prej më se 20 personash do ta bënte Agjencinë edhe më funksionale dhe shpresojmë kjo do të arrihet në një të ardhme të afërt.

AAAPARr për një funksionalizim të plotë duhet të funksionojë sipas strukturës organizative të mëposhtme:



Zhvillimi i AAP-së në Kosovë, në përputhje me standardet e kërkuara evropiane, është një përgjegjësi e madhe po aq sa është edhe sfidë profesionale. Agjencia e ka marrë përsipër këtë mision, duke ofruar transparencë të plotë në punën e saj për ta ngritur AAP-në e Kosovës në një tjetër nivel, duke mundur një cilësi më të lartë të shërbimeve profesionale.

Hyrje

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2019 është vazhduar zbatimi i dispozitave që burojnë nga Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur nr. 04/L-138, në bazë të të cilit është themeluar dhe zhvillon aktivitetet Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr). Gjatë këtij periudhe është vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara në sektorin për çështje pedagogjike dhe profesionale si dhe në sektorin e administratës dhe financave, të bazuara në legjislacionin në fuqi, Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021, si dhe Planit Vjetor të Punës së Agjencisë, i cili plan është bërë në harmoni me planet e shkollave partnere që Agjencia e AAPARr-së i ka në menaxhim.

Rezultatet e arritura të AAAPARr-së gjatë këtij viti janë të ndërlidhura me objektivin 6 të AAP-së në PSAK 2017-2021 si më poshtë:

- Numri i shtuar i nxënësve në drejtimet deficitare dhe i femrave në drejtimet teknike;
- Materiale mësimore të zhvilluara nga ekspertët e profileve përkatëse të mbështetur nga AAAPARr;
- Janë zhvilluar katër standarde të profesionit për nivelin e pestë të kualifikimeve për profilet arsimore “Metalpunues”, “Automekanik”, “Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit” dhe “Rrobaqepësi”;
- Realizimi i praktikës profesionale të nxënësve në shkollë dhe jashtë shkolle në përputhje me programin mësimor;
- Hapja e tri qendrave për karrierë;
- Autonomia e përsëritshme financiare dhe menaxhuese e institucioneve të AAP dhe ARr;
- Kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rritur;
- Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve etj.

Implementimi i nivelit V

Diplomojnë 75 asistentë për nxënës/fëmijë me nevoja të veçanta arsimore



Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR), së bashku me ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, Daniele Passalsqua, udhëheqës i Projektit LuxDev dhe Bujar Kadriu nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, kanë ndarë certifikatat për 75 kandidatët e diplomuar të gjeneratës së dytë për asistentë për nxënës/fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Zymberi, duke u uruar suksese të mëtutjeshme të diplomuarve, ka thënë se institucioni që ajo drejton ka bashkëpunuar me MASHT-in dhe LuxDev që në Kosovë të ofrohet një kualifikim të tillë i cili është shumë i nevojshëm për këtë kategori. “Pra, kemi arritur që të realizojmë një kualifikim të njohur ndërkombëtarisht në përputhje të kërkesave të tregut të punës”, ka shtuar Zymberi, duke theksuar se punësimi i asistentëve ndikon në rritjen e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta dhe lehtësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Ndërsa ministri Bytyqi, pasi ka uruar asistentët për mbështetjen në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, në kuadër të sistemit të rregullt arsimor, ka thënë se zbatimi i politikave arsimore që ofrojnë mbështetjen e nevojshme për këtë kategori të fëmijëve është i një rëndësie të jashtëzakonshme. “Arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është sfidë jo vetëm për Ministrinë e Arsimit, por për gjithë shoqërinë, andaj edhe jemi angazhuar që t’i përgatisim kuadrot e nevojshme për këtë qëllim”, ka thënë ministri Bytyqi. Ministri Bytyqi theksoi se këtë vit MASHT-i ka krijuar mundësi për punësimin e 100 asistentëve në shkolla dhe kjo do të vazhdojë edhe për tri vjetët e ardhshëm. Bujar Kadriu nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar ka thënë se pa një arsimim për fëmijët me nevoja të veçanta nuk mund të thuhet se në një shoqëri ka përparim. “Nuk jam i kënaqur me punësimin e kandidatëve për këtë kategori nëpër komuna”, ka theksuar ai.



Gjatë vitit 2016 AAAPARr, në bashkëpunim me MASHT-in, mori iniciativë që për herë të parë në sistemin formal të arsimit ta prezantojë edhe nivelin V të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” që është zhvilluar nga PEARSON, institucion prestigjioz Britanik, ndërsa është financuar nga projekti Lux-Development.



Pearson është kompani udhëheqëse për mësimnxënie në botë, me 40000 të punësuar në më shumë se 70 vende që punojnë për t'i ndihmuar njerëzit e të gjitha moshave për të bërë përparim të matshëm në jetën e tyre përmes të të mësuarit.

Vazhdohet edhe me gjeneratën e tretë

AAAPARr, në bashkëpunim me MASHT-in dhe me projektin e financuar nga Qeveria e Luxemburgut, Lux/Dev, kanë vazhduar edhe për vitin 2019 ofrimin e kualifikimit për nivelin Vtë arsimit sipas KKK (Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) për “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore”. Gjenerata e tretë për këtë kualifikim realizohet në Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë dhe në Qendrën Burimore “Xheladin Deda” në Pejë për vitin shkollor 2019/2020.



Diplomon gjenerata e parë për “Këshilltar karriere” në nivelin V të kualifikimit

Në mënyrë solemne është bërë ndarja e diplomave të gjeneratës së parë të studentëve “Këshilltarë karriere”, për nivelin V dhe për nivelin III-IV të profilit Ekonomi, Tregti dhe Turizëm për nxënësit e Qendrës së Kompetencës në Prizren.



Drejtori i Qendrës së Kompetencës AliismetÇoçaj ka thënë se është një ditë tejet e rëndësishme për këtë institucion. “Falëpunës dhe përkushtimit të nxënësve, studentëve dhe mësimeve po bëhet shpërndarja e këtyre diplomave që njihen ndërkombëtarisht”, ka thënë ai. Edhe Muhamer Ibriqi nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, si dhe Agon Jusufi nga organizata LuxDevelopment e kanë vlerësuar tejet të rëndësishme këtë ngjarje të diplomimit të gjeneratës së parë të studentëve dhe nxënësve për orientim në karrierë.



Në këtë ceremoni janë shpërndarë diploma për 23 nxënës për nivelin III-IV të Qendrës së Kompetencave në Prizren dhe për 20 studentë të tjerë të nivelin V.

Tre udhëzues të ri

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARr) edhe gjatë vitit 2019 ka angazhuar ekspertë të fushave të ndryshme për realizimin e disa udhëzuesve të cilët do të shërbejnë për mësimdhënësit e shkollave profesionale. Gjatë këtij viti janë realizuar tre udhëzues, të cilët do të jenë në shërbim të mësimdhënësve:

“Bashkëpunimi me punëdhënësit” nga Msc.Besart Shala; “Teknologjia e dirigjimit kompjuterik (torno)” nga Msc.ing. Ardian Ramadani, si dhe “Rregullimi i trafikut” nga Mr.sc.AliMiftari.



Arsimi profesional, një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit

Është mbajtur konferenca e tretë vjetore nga Agjencia për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) me temë "Arsimi profesional, një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit". Në konferencë u prezantuan të arriturat e Agjencisë, gjithashtu sfidat dhe mundësitë e përmirësimit të tyre në një vizion të zhvillimit ekonomik të vendit.



Në Konferencë u prezantuan 18 udhëzues të përgatitur nga ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët do të jenë në shërbim të shkollave dhe nxënësve, si dhe u diskutua për bashkëpunimin me bartësit relevantë, për realizimin e aktiviteteve të AAP-së dhe projektet për reformimin e sistemit të arsimit profesional në Kosovë.



Ministri Bytyqi me këtë rast theksoi se ekonomia e vendit varet nga cilësia e sistemit të arsimit të të rinjve në shkolla, në veçanti në shkollat profesionale.



Ministri Bytyqi tha se vëmendje e veçantë duhet t'ikushetohet ngritjes së standardeve të shkollave profesionale, pasi që tashmë është një kërkesë e vazhdueshme e të rinjve tanë për t'u orientuar në këto shkolla. Ministri Bytyqi vlerësoi se MASHT-i duke e konsideruar shumë të rëndësishëm zhvillimin e arsimit profesional ka zhvilluar dhe vazhdon të investojë në zhvillimin e infrastrukturës ligjore, e cila është në funksion të ngritjes së cilës është në arsimit. Ministri Bytyqi tha se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ngritjes së standardeve të shkollave profesionale, pasi që tashmë është një kërkesë e vazhdueshme e të rinjve tanë për t'u orientuar në këto shkolla.




Ndërsa Fikrije Zymberi, u. d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, në këtë konferencë ka prezantuar të arriturat dhe sfidat e këtij institucioni gjatë kësaj periudhe.

Mbahet Panairi i Edukimit

Është mbajtur Panairi i Edukimit, i organizuar nga KompaniaCEO (CongressEventOrganization), në të cilin kanë marrë pjesë edhe shkollat partnere të AAAPARr-së. Qëllimi i këtij panairi është që të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes së nxënësve dhe studentëve, por edhe institucioneve rreth informimit, përzgjedhjes dhe avancimit të tyre profesional, gjithashtu edhe mundësisë së përfitimit të fondeve (punë praktike, bursa, intershipetj). Është mundësi e mirë që shkollat e AAP-së dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë ta informojnë dhe ta promovojnë punën e vet.

Po ashtu, kjo ngjarje ka për qëllim zgjerimin e rrjetit të kontakteve në mes të institucioneve arsimore si dhe takimeve me nxënës, studentë dhe udhëheqës të institucioneve arsimore vendore dhe të huaj.



Në këtë ngjarje me prezantimet e punëve të tyre morën pjesë edhe nxënësit e shkollave partnere të AAAPARr-së: ShMLT “11 Marsi” në Prizren; ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë; të Qendrës së Kompetencës në Skenderaj; të Qendrës së Kompetencës në Malishevë; të Qendrës së Kompetencës në Ferizaj dhe të Qendrës së Kompetencës në Prizren.



Nxënësit prezantuan punën dhe aktivitetet e tyre në bazë të drejtimeve dhe profileve përkatëse duke i njoftuar të rinjtë dhe pjesëmarrësit e tjerë në panair me shkollat/qendrat e tyre si një mundësi promovimi, informimi dhe bashkëpunimi.

Gjithashtu, qëllimi i pjesëmarrjes në këtë panair ishte promovimi i punës së nxënësve të Qendrave të Kompetencës dhe Shkollave Profesionale që janë në kuadër të AAAPARr-së, ngritja e vetëdijes së nxënësve për t'i ndjekur mësimet në këto shkolla profesionale, kontribuimi në tregun e punës dhe zhvillimi social i vendit, krijimi i lidhjeve në mes të punëdhënësve dhe punëkërkesve etj.

Shkollat e AAAPARr-së, të parat në procesin e validimit dhe akreditimit

Gjashtë shkollat partnere të AAAPARr-së janë shkollat e para në Kosovë që kanë aplikuar për procesin e validimit dhe akreditimit të programeve. Qendra e Kompetencës në Ferizaj është validuar dhe akredituar në dy profile që ka aplikuar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), ndërsa pesë qendrat e tjera janë në fazën finale për t'u validuar dhe akredituar. Pritet që deri në muajin korrik të këtij viti të përfundojnë procedurat dhe të akreditohen edhe këto qendra me profilet e caktuara.

Katër standarde të zhvilluara të profesionit

Gjatë kësaj periudhe të vitit shkollor 2018/2019 janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen hapa përparimtar në ngritjen e kapaciteteve të shkollave. Janë zhvilluar katër standarde të profesionit për nivelin e pestë të kualifikimeve për profilet arsimore “Metalpunues”, “Automekanik”, “Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit” dhe “Rrobaqepësi”.



Firkije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, gjatëprezantimit të draft-standardeve tëprofesioneve “Ngrohje qendrore dhe klimatizim”dhe “Rrobaqepësi” për nivelin V të kualifikimeveka theksuar se zhvillimi i këtyre standardeve është shumë i rëndësishëm.

Inaugurohen tri qendra për karrierë

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të Rriturve (AAAPARr), në partneritet me projektin “Rritja e Punësimit për të Rinj (EYE)” e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), kanë themeluar tri qendra për karrierë në kuadër të shkollave partnere: Qendrën e Kompetencës në Malishevë, ShMLT “11 Marsi” në Prizren dhe ShMLP “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë.

Këto qendra janë të vendosura brenda kompleksit të shkollës, ku me ndihmën e zyrtarëve që do të punojnë në këto qendra, do t’i udhëzojnë të rinjtë që ta kuptojnë botën e punës për ta zhvilluar karrierën e tyre.



Hapja e këtyre qendrave ka për qëllim mbështetjen e nxënësve për përmirësimin e shkathtësive për menaxhim të karrierës, ndërlidhjen me tregun e punës, shkëmbimin e

informacioneve mbi tregun e punës, edukimin dhe trajnimin e tyre si dhe rrjetëzimin e suksesshëm me palët e interesit.

Hapja e këtyre tri qendrave, sipas Fikrije Zymberi, u.d.e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, është bërë me qëllim të përkrahjes së nxënësve në zhvillimin e kompetencave për menaxhim më të mirë të karrierës së tyre dhe ndërlidhjen me tregun e punës, si dhe fasilitetit të nxënësve të shkollave profesionale në rrugën e tranzicionit nga shkolla në punë.

Inaugurimi i Qendrës së Karrierës në Qendrën e Kompetencës në Malishevë



Gjatë inaugurimit të Qendrës për Karrierë në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, të pranishëm ishin edhe kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj, KatrinOchsenbein, këshilltare Rajonale për Ekonomi dhe Punësim, përfaqësuesnga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC), Valbona Rraci, zyrtare e lartë e projektit EYE si dhe përfaqësues nga komuna të ndryshme dhe pronarë të bizneseve.

Inaugurimi i Qendrës së Karrierës në ShMLT “11 Marsi” në Prizren



Gjatë inaugurimit të Qendrës për Karrierë në ShMLT “11 Marsi” në Prizren ishintë pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Prizrenit, EshrefMemaj, përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, përfaqësues të biznesit etj.

Inaugurimi i Qendrës së Karrierës në ShMLP “ShtjefënGjeçovi” në Prishtinë




Me rastin e inaugurimit të Qendrës për Karrierë në ShMLP “ShtjefënGjeçovi” në Prishtinë ishte e pranishme edhe drejtoresha e DKA-së në Prishtinë, Shpresa Shala, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, përfaqësues të bizneseve dhe shkollave të ndryshme.


Vizitat zyrtare

Ndërtimi i urave për arsimin e të rriturve

Nën organizimin e DVV-Internacional dhe me ftesë të Departamentit të Pedagogjisë dhe Andragogjisë - Universiteti i Beogradit është mbajtur konferenca dyditore rajonale, e pestë me radhë, “Të ndërtojmë ura në arsimin e të rriturve”, që është mbajtur në Beograd. Vendet pjesëmarrëse ishin: Kosova, Kroacia, Sllovenia, Serbia, Maqedonia, Bosnja dhe Mali i Zi. Në delegacionine Kosovës ishin përfaqësues nga MASHT, APRK dhe AAAPARr. Qëllimi i konferencës është shkëmbimi i përvojave të mira në mes të shteteve dhe me që mbahet çdo vit, raportohet nga secili shtet për të rejtat e fundit në fushën e arsimit të rriturve.



Në ditën e parë të konferencës, në pjesën e paradites, janë bërë prezantimet dhe incizimet nga secilit shtet pjesëmarrës. Prezantimi nga Kosova, që është prezantuar nga Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, kishte të bënte me qendrat e kompetencës dhe me QAP, meqë kanë të bëjnë me arsimin e të rriturve. Po ashtu, është prezantuar edhe një incizim i praktikave të mira nëpër këto qendra, ku kryesisht kanë qenë të intervistuar nxënësit e suksesshëm.



Pjesa e pasdites është organizuar në grupe dhe ishte më e rëndësishmja e takimit. Në pesë grupe të ndara ka marrë pjesë nga një pjesëmarrës nga Kosova. Temate diskutimit brenda grupit ishin sfiduese në arsim e të gjitha vendeve pjesëmarrëse, si,

1. Menaxhmenti;
2. Trajnerët;
3. Programet;
4. Bashkëpunimi;
5. Pajisjet.

Detyra ishte që për secilin grup të emërtohet një përparësi dhe një dobësi që ballafaqohet shteti përkatës. Në fund doli që afërsisht të gjitha shtete pjesëmarrëse t'i kenë sfidat e ngjashme.

Pas prezantimit, detyrë tjetër ishte të radhiten sipas prioriteteve tri nga përparësitë dhe pastaj tri nga sfidat që na kanë dalë nga kjo konferencë. Sfida të njëjta ishin: financat, menaxhmenti joprofesional dhe mungesa e bashkëpunimit.

Hapi tjetër i detyrës ishte mënyra apo rruga që këto sfida t'i kthejmë në realizim. Sipas agjendës, dita e dytë ishte vizitë Shkollës Bujqësore në Pozharevc dhe Muzeut Arkeologjik. Gjatë kësaj vizite të pranishmit janë informuar për numrin e nxënësve që janë në shkollë, kabinetet, pjesën e jashtme ku mbahet praktika, si dhe konviktet që ishin në kuadër të shkollës.

Iniciativa e trajnimit dhe njohja e kompetencave

Në Munih të Gjermanisë është mbajtur takimi i pestë me radhë i Komitetit Drejtues të projektit YES-GIZ. Tema e diskutimit ishte “Iniciativa e trajnimit dhe njohja e kompetencave”. E pranishme në takim nga delegacioni i Kosovës ishte edhe Fikrije Zymberi,

u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, por kishte edhe përfaqësues nga MASHT-i, AKK etj.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi rreth përafrimit të kualifikimeve duke pilotuar sektorin e ndërtimtarisë dhe duke u bazuar në nevojën e madhe të personave të kualifikuar si në Kosovë ashtu edhe në Gjermani.



Pas prezantimeve të ndryshme në pjesën e parë të takimit, pasdite kishte kryesisht diskutime rreth mundësisë së adaptimit të disa elementeve të arsimit dual nëpër shkollat profesionale në Kosovë. Po ashtu, përfaqësuesit nga Kosova kanë paraqitur gjendjen aktuale të AAP-së në Kosovë, ku secili ka bërë nga një prezantim të shkurtër, po ashtu edhe rreth trajnimeve nëpër QAP dhe më shumë për trajnimin e kombinuar meqë lidhej më shumë me temën e diskutimit. Në fund është arritur marrëveshje për hapat e mëtejshëm që të realizohen deri në takimin e radhës dhe gjithëherë në mbështetje të Projektit YES/GIZ për:

-Përdorimin e standardit të muratorit si dhe validimi i kurrikulës, por edhe njohja e saj në Gjermani;

-Trajnimi i instruktorëve në ndërmarrje si një element kyç i arsimit dual;

-Trajnerëve në lëmin e ndërtimtarisë dhe makatronikës.

Për të gjitha këto çështje GIZ-i ka angazhuar një ekspert deri në fund të vitit 2020 për ta përkrahur realizimin e këtij procesi.

Autonomia dhe përgjegjësia arsimore

Në Sarandë është mbajtur Konferenca e 11-të Ndërkombëtare, me temë “Autonomia dhe përgjegjësia arsimore-krahasimi i sistemeve arsimore”. Pjesëmarrës ishin udhëheqës të shkollave dhe përfaqësues të ministrive përkatëse nga Italia, Shqipëria dhe Kosova. Drejtues të shkollave nga Italia dhe Shqipëria gjatë kësaj konference kanë shprehur interesimin dhe gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me shkollat e Kosovës. Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë pasur rastin të shikojnë edhe një videoincizim treminutësh të realizuar në ShMLT “11 Marsi” në Prizren.



Bashkëpunimi për AAP

Në Tiranë është mbajtur punëtorja dyditore me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë për arsimin dhe aftësimin profesional. Gjatë kësaj punëtorie është bërë:

- Prezantimi i implementimit të të mësuarit në vend të punës;
- Prezantimi i Kornizës së Kurrikulit për AAP dhe komenteve;
- Prezantimi nga AAFP Tiranë për standardet ekzistuese të profesionit në Shqipëri.



Vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut

Me ftesë të Qendrës për Arsimin e të Rriturve, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, Fikrije Zymberi, së bashku me stafin e këtij institucioni kanë qenë për vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përfaqësuesit e këtij institucioni kanë qenë për vizitë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe institucione të tjera relevante të arsimit profesional, siç është Qendra për Arsimin e të Rriturve, Qendra për Arsimin Profesional dhe Trajnime, si dhe në Shkollën e Mesme Profesionale të Shkupit “Boro Petroshevski”. Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëpunimit në mes të dy vendeve në fushën e arsimit profesional dhe arsimin e të rriturve, duke shkëmbyer përvojat dhe modelet e dy vendeve në mirë e arsimit dhe tregut të punës.



Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kanë pasur takime me përfaqësues të Sektorit për Arsimin e Mesëm, Arsimin e të Rriturve dhe Mësim Gjatë Gjithë Jetës.

U.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, Fikrije Zymberi, gjatë këtij takimi kaprezantuar një pasqyrë të shkurtër të Agjencisë. Kurse janë njoftuar se një nga aktivitetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut është formimi i triqendrave të ekselencës që do të funksionojnë në kuadër të qendrave ekzistuese. Është paraparë që në vitin 2022 të hapen këto qendra. Po ashtu, kanë theksuar se pilotohet sistemi dual, ndërsa këtë vit ky sistem (sistemi dual) është zgjeruar edhe në disa vende të tjera. Për arsimin e rriturve Ministria e bën vendimin për provajder. Po ashtu, bën verifikimin e institucioneve që zhvillojnë aktivitete të tilla. Ata kanë theksuar se edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka mungesë të teksteve shkollore, ndërsa teksti është i obliguar të dorëzohet në gjuhën maqedonase. Për zhvillim në karrierë janë të hapura gjithsej 43 qendra.

Vizitë në Qendrën për Arsimin e të Rriturve

Gjatë këtij takimi u njoftuan me veprimtarinë e verifikimit të programeve për arsim për të rritur që kanë filluar në janar të vitit 2012, ndërsa shfrytëzojnë fonde nga Bashkimi Evropian, nga IPA. Buxheti në QARr është relativisht i vogël, por falë donatorëve i realizojnë këto programe. Stafin në këtë qendër ka filluar me 5, 6 persona, ndërsa tani janë 18. Në këtë Qendër kishte ballafaqime të ndryshme, së pari me objektin, pastaj buxheti që u jepet nuk është i mjaftueshëm, ka mungesë të resurseve njerëzore. Por, para vitit 2008 kanë qenë sektor në Ministrinë e Arsimit.



Kjo Qendër funksionon me Këshill Drejtues dhe vitin fiskal e përfundon pa borxhe. Për çdo program paguan 150 euro që zgjat tri vjet. Qendra për Arsimin e të Rriturve në Shkup është afirmuar nga viti 2009.

Vizitë në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnime



Vizitë në Shkollën e Mesme Profesionale “Boro Petroshevski”, Shkup



Vizitë në Athinë

Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, së bashku me profesorin Jetmir Zymberi ka marrë pjesë në trajnimin “EU Funding From A to Ω”, organizuar nga EVBB (European Association of Institutes for Vocational Training - Asociacioni Evropian i Instituteve për Arsimin Profesional, me qendër në Bruksel) në partneritet me AKMI (Institute of Vocational Training - Institut për Arsim dhe Aftësim Profesional me qendër në Athinë/Greqi).



Trajnimin e hapi me një fjalë përshëndetëse presidenti i grupit të kompanive nga AKMI, Konstantinos Rodopoulos, i cili falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe foli për historikun, organizimet dhe aktivitetet e AKMI-së. Menjë fjalimiu drejtua pjesëmarrësve edhe Horst Dreimann (sekretari i përgjithshëm i EVBB-së), i cili foli për aktivitetet e EVBB-së. Ai gjatë fjalimit të tij vuri theksin edhe te Kosova, duke përmendur veçanërisht Fikrije Zymberi nga AAAPARr që në bashkëpunim me EVBB dhe PARAGON nga Malta kishte realizuar projektin e dërgimit të nxënësve për kryerjen e internshipit në Malta.



Përmendi, gjithashtu, vështirësitë që Kosova ka në lidhje me sigurimin e vizave dhe përpjekjet e vazhdueshme për të realizuar projekte në bashkëpunim me anëtarët e tjerë nga EVBB. Ai kërkoi nga pjesëmarrësit që ta kenë parasysh Kosovën dhe të krijojnë lidhje më të ngushta bashkëpunimi me Fikrije Zymberi nga AAAPARr. Gjatë këtij trajnimi ka pasur prezantime dhe diskutime të shumta.



Kurse Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, diskutoi me panelistët në lidhje me institucionet për validimin e kualifikimeve, pastaj për ECTS dhe ECVET, për numrin e orëve të mësimit, për kreditë dhe nivelet e kualifikimit.

Marrëveshjet e bashkëpunimit

Pjesëmarrja në Panairin e Edukimit

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për Panair të Edukimit që organizohet në Kosovë ndërmjet Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) dhe Kompanisë CEO (CongressEventOrganization).



Qëllimi i këtij memorandum bashkëpunimi dhe marrëveshjeje është promovimi i punës së qendrave të kompetencës dhe shkollave profesionale që janë në kuadër të AAPARR-së, ngritja e vetëdijes së nxënësve për t'i ndjekur mësimet në këto shkolla profesionale, kontribuimi në tregun e punës dhe zhvillimit social të vendit, krijimi i lidhjeve në mes të punëdhënësve dhe punëkërkesve etj.

Qendra për Karrierën e Shkollave do të themelohet edhe në shkollat e AAPARr-së



Me qëllim të përmirësimit të aftësive dhe kompetencave të nxënësve të shkollave të AAP-së për një orientim më të mirë të karrierës u nënshkrua Memorandum Mirëkuptimi (MOU) midis Projektit EYE, Agjencisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AVETAE), i themeluar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), mandati i të cilit është t'i mbështesë institucionet e AAP në Kosovë për një edukim të fortë drejt rritjes së aftësive dhe kompetencave.



Të pranishëm ishin drejtorët e tri shkollave partnere: Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, Shkolla “11 Marsi” në Prizren dhe Shkolla “Shtjefën Gjeqovi” në Prishtinë.

Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i qendrave për karrierë me bazën shkollë, në shkollat partnere të AAAPARr-së. Rreth 3500 studentë do të përfitojnë nga shërbimet që do t'i ofrojnë këto tri qendra të karrierës.

EYE do ta mbështesë ngritjen e këtyre qendrave duke përfshirë renovimin e objekteve me pajisjet dhe mjetet e nevojshme, trajnimin e stafit të qendrës së karrierës dhe ofrimin e asistencës teknike për zbatimin e planit vjetor dhe monitorimin e projektit. Shkollat janë zotuar t'i ndajnë burimet e nevojshme për t'i drejtuar këto qendra.


Marrëveshja me APPK-në

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARR), e përfaqësuar nga znj. Fikrije Zymberi dhe z. BedriXhafa nga Agjencia për Përkrahjen e Punësimit në Kosovë (APPK), kanë nënshkruar një aneks marrëveshje. APPK autorizohet nga AAAPARr që nga të hyrat vetjake t'i realizojë transaksionet financiare edhe për pagesën e pagave të trajnerëve/ekspertëve për implementimin e niveleve V të kualifikimit.

Zhvillimi i dy standardeve

Fikrije Zymber, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së dhe RamadanAlia nga DVV International, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimin për zhvillimin e dy standardeve të profesioneve për nivelin V të kualifikimeve gjatë vitit 2019.

Zymberi dhe Alia e kanë vlerësuar shumë të rëndësishëm zhvillimin e standardeve të profesionit për Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit dhe Rrobaqepësi, për nivelin e pestë të kualifikimeve sipas KKK-së.



Marrëveshja me D&DBusinessSupportCenter

Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARR-së dhe Safet Fazliu, drejtor i D&D Business Support Center, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Përfaqësuesit e dy institucioneve u zotuan që të bashkëpunojnë në projekte dhe aktivitete të ndryshme, të cilat shkojnë në funksion të gjenerimit dhe lehtësimit të punësimit, vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë, në veçanti për grupet e marginalizuara, siç janë: të rinjtë, gratë, personat e riatdhesuar, grupet në nevojë dhe komunitetet rurale në Republikën e Kosovës.



Grupet dhe komunitetet e lartpërmendura, të cilët marrin shërbime nga D&D, do t'u jepet hapësirë nga AAAPARR që të përfshihen edhe në trajnime profesionale, përmes Qendrave të Kompetencës dhe Shkollave Profesionale që menaxhohen nga AAAPARR.

Për më tepër, D&D, në kuadër të kësaj marrëveshje, do të mbështesë AAAPARR përmes asistencës teknike dhe profesionale në arritjen e objektivave të saj, përmes ofrimit të ekspertizës profesionale në fushën e Planifikimit strategjik, Standardizimit, Partneritetit Publiko Privat, Studimeve të Fizibilitetit, Transformimit Digjital dhe Auditimit të Sistemit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur.

Marrëveshja me Finlandën

Është nënshkruar memorandum bashkëpunim në mes të AAAPARR-së, Autoritetit të Përbashkët Komunal Sinajoki për Arsim Sedu (Finlandë) dhe Qendrës së Kompetencës në Ferizaj. Qendra e Kompetencës menaxhohet nga AAAPARR dhe ofron profile shëndetësore si: Kujdesin social dhe shëndetësor; Teknik dentar; Optikë; Sigurinë ushqimore dhe dietat; Teknik i farmacisë si dhe Asistent i fizioterapisë. Sedu dhe Qendra e Kompetencës kanë rënë dakord ta nxisin bashkërisht bashkëpunimin në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor në Finlandë për nxënësit e kësaj qendre që kanë diplomuar. Ky bashkëpunim do të ndihmojë në zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e kujdesit social dhe shëndetësor duke krahasuar sistemet arsimore dhe profilet në kujdesin shëndetësor për t'i ndihmuar nxënësit e përzgjedhur nga Kosova.



Marrëveshja me Lux/Dev

Nënshkrimi i marrëveshjes në mes të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësisit Profesional dhe Arsimit të Rriturve dhe Lux/Development në emër të Projektit KSV/020 “Mbështetja për Reformën e Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Kosovë” - Faza 2, për realizimin e mbështetjes në Qendrat e Kompetencës në Ferizaj, Prizren si dhe në shkollat e mesme të larta profesionale “ShtjefënGjeçovi” në Prishtinë dhe “11 Marsi” në Prizren.



Marrëveshje me Smart Bits

AAAPARr dhe Smart Bits kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit për implementimin e platformës elektronike për orientim dhe këshillim në karrierë Busulla.com në gjashtë shkollat partnere të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Palët nënshkruese janë zotuar për implementimin e këtij memorandumi.



Marrëveshja me ALLED 2

Është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi në mes të AAAPARr-së, ShMLT “11 Marsi” dhe Projektit ALLED 2.



Projekti “ALLED 2” synon zvogëlimin e varfërisë përmes rritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës dhe përmirësimit të punësimit të qytetarëve të Kosovës. Qëllimi specifik i projektit është rritja e cilësisë dhe rëndësisë së programeve të arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës dhe mbështetja në përshtatjen e kornizës dhe mekanizmave ligjorë si parakusht për rritjen e punësueshmërisë në Kosovë.

Trajnimet

Trajnimet për mësimdhënësit që janë realizuar gjatë vitit 2019 Qendra e Kompetencës në Skenderaj

1. Trajnimi për profilin beton punues. Ky trajnim është realizuar në QK Skenderaj nga trajnerët DanielLutz dhe FrankTonhäuser, që janë ekspertë nga Akademia Shtetërore e LanditBadenWürttemberg. Në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit janë certifikuar nga Landesakademie - Stuttgart.

2. Trajnim për përdorimin e programit softuerik Cad Works. Ky trajnim i realizuar në QK Skenderaj është realizuar nga trajnerët DanielLutz dhe FrankTonhäuser, që janë ekspertë nga Akademia Shtetërore e LanditBadenWürttemberg. Në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit janë certifikuar nga Landesakademie - Stuttgart.

3. Dirigjimi kompjuterik i makinave CNC. Trajnimi për dirigjimin kompjuterik të makinave CNC është organizuar nga GIZ dhe Bonevet Prishtina.

4. Trajnim për elektronikë. Ky trajnim është organizuar nga GIZ dhe Bonevet Gjakovë.

5. Testimi i platformës elektronike E-Learning që është organizuar nga GIZ dhe projekti YES.

6. Sigurimi icilësisë në IAAP, organizuar nga GIZ dhe projekti YES.

7. Trajnimi për multiplikatorë. Ky trajnim është realizuar nga trajnerët DanielLutz dhe FrankTonhäuser, që janë ekspertë nga Akademia Shtetërore e LanditBadenWürttemberg. Në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit janë certifikuar nga Landesakademie - Stuttgart.

8. SmartHomeEurope. Ky trajnim është mbajtur në QK Shkollë, trajnim që ka të bëjë me teknologjinë e re për organizimin e brendshëm dhe të jashtëm të objekteve të banimit, në pajisje elektrike, sanitare, sigurie, sistem të ngrohjes, ujit etj. Ky trajnim është mbështetur nga GIZ-DIMAK.

9. Trajnimi në nivel vendi. Trajnimi dyjavor i organizuar nga GIZ-i me përkrahjen e MASHT-it për mësimdhënësit e shkollave nga vendi është mbajtur në QK Skenderaj. Ky trajnim vazhdon edhe në dy faza të tjera.

Temat e trajnimit janë:

- Moduli 1: Zhvillimi i detyrave mësimore dhe të punës;
- Moduli 2: Zhvillimi i projekteve të ndërtimtarisë;
- Moduli 3: Zhvillimi i projekteve për konsumatorë të ndërtimtarisë;
- Moduli 4: Zhvillimi i projekteve për bashkëpunim mësimor.

10. Trajnerët në Kompani në Ndërtimtari (Projekt nga BMZ-Bavaria). Trajnim për trajnerët në kompani, ku do t'i përgatisin nxënësit gjatë realizimit të praktikës profesionale në ndërmarrje.

Qendra e Kompetencës në Ferizaj

1. Udhëheqja arsimore e organizuar nga Sindikata e Arsimit të Kosovës
2. Dialogu Social i organizuar nga Sindikata e Arsimit të Kosovës, trajnim ky që vlen për rilicencim të mësimdhënësve.

ShMLT “11 Marsi”, Prizren

1. Trajnimi i mësimdhënësve nga Akademia Digjitale
2. Trajnimi për 3D Printerët dhe SQL serverët organizuar nga ICK dhe CACTUS
3. Trajnimi për dizajnimin e uebfaqeve përmes Front dhe End development
4. Trajnimi 15 ditor për orientim në karrierë nga projekti EYE
5. Trajnimi për udhëheqje arsimore organizuar nga MASHT
6. Trajnimi për Qarqe të Integruara - ARDUINO
7. Trajnimi për elektronikë dhe ndërtimtari nga projekti “Bonevet”
8. Trajnimi për punë praktike në ndërtimtari në QK Skenderaj nga Akademia Shtetërore e LanditBadenWürttemberg.

ShMLP “ShtjefënGjeçovi”

1. Mbrojtja dhe siguria në punë
2. Instruktor në vendin e punës
3. Zhvillimi i kapaciteteve në udhëheqje arsimore
4. Orientimi dhe Këshillimi në karrierë
5. Zhvillimi i kapaciteteve në udhëheqje arsimore
6. Sistemi CBET, metodat praktike të të mësuarit
7. Trajner në kompani

Vlerësohet bashkëpunimi me shkollat

Me rastin e pensionimit të Faik Salihut, drejtorit të ShMLP “ShtjefënGjeçovi” në Prishtinë, është organizuar një drekë, ku të pranishëm ishin Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit, stafi i Agjencisë, drejtorë dhe zv/drejtorë të shkollave partnere.



Zymberi me këtë rast ka falënderuar drejtorin për kontributin e dhënë në edukimin e shumë gjeneratave. “Faleminderit që për shumë vite ke kontribuar në sistemin e arsimit të Kosovës, për bashkëpunimin e deritashëm që kemi pasur, si dhe për përkrahjen që i keni dhënë Agjencisë”, ka shtuar Zymberi.

Kurse Salihuka bërë me dije se po pensionohet me 40 vjet kontribut në sistemin e arsimit. “Është kënaqësi që kam punuar tërë këto vite në arsim. Jammunduar të jap më të

mirën për edukimin e shumë brezave, por jam i lumtur që shkolla jonë ka përparuar dhe besoj se do të ketë suksese të njëpasnjëshme”, ka shtuar ai.



Konferenca e 4-t vjetore “Arsim për punësim”

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur ka mbajtur Konferencën e 4-t vjetore me moton “Arsim për punësim”, ku të pranishëm ishin përfaqësues të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.



Në këtë konferencë janë prezantuar edhe tre udhëzuesit që janë realizuar nga ekspertë të fushave të ndryshme që ka angazhuar AAAPARR, të cilët do të shërbejnë për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave profesionale: “Bashkëpunimi me punëdhënës” nga Msc.Besart Shala; “Teknologjia e dirigjimit kompjuterik (torno)” nga Msc.ing. Ardian Ramadani, si dhe “Rregullimi i trafikut” nga Mr.sc.AliMiftari.



Fikrije Zymberi, u.d. e drejtorit të përgjithshëm të AAAPARr-së, duke falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, ka bërë me dije se në periudhën janar-dhjetor të vitit 2019 ky institucion ka vazhduar zbatimin e dispozitave që burojnë nga Ligji për AAP dhe ARr nr. 04/L-138, në bazë të të cilit është themeluar dhe zhvillon aktivitetet AAAPARr. Gjithashtu, ka theksuar se gjatë kësaj periudhe është vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara sipas planit vjetor të punës së Agjencisë, i cili plan është në harmoni me planet e shkollave partnere që Agjencia e AAPARr-së i ka në menaxhim dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi, Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021.



Zymeri ka bërë me dije se rezultatet e arritura të AAAPARr-së gjatë këtij viti janë të ndërlidhura me objektivin 6 të AAP-së në PSAK 2017-2021 si:

“Numri i shtuar i nxënësve në drejtimet deficitare dhe numri i femrave në drejtimet teknike”;

“Materialet mësimore të zhvilluara nga ekspertët e profileve përkatëse të mbështetur nga AAAPARr”;

“Standardet e profesionit për nivelin e pestë të kualifikimeve për profilet arsimoretë zhvilluara për: Metalpunues, Automekanik, Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit dhe Rrobaqepësi”;

“Realizimi i praktikës profesionale të nxënësve në shkollë dhe jashtë shkolle” në përputhje me programin mësimor;

“Hapja e tri qendrave për karrierë; Autonomia e përsëritshme financiare dhe menaxhuese e institucioneve të AAP-së dhe ARr-së”;

“Kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore për menaxhimin e arsimit për të rritur”;

“Është rritur oferta e shkollimit në nivelin 5 të kualifikimeve etj” është zhvilluar kualifikimi BTEC i këtij niveli për “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta”, Këshilltar për karrierë”, ka theksuar Zymeri.



Gjatë kësaj konference kanë prezantuar edhe Valbona Fetiu-Mjeku nga Divizioni i AAP-së të MASHT-it, e cila ka folur sa i përket harmonizimit të proceseve të AAP-së konform standardeve rajonale dhe më gjerë.



Milot Hasangjekaj nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka folur për rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e AKK-së.



Valbona Rraci nga projektiEYE ka folur rreth funksionalizimit dhe rrjetëzimit të qendrave të karrierës në shkolla, ku këtë vit në bashkëpunim me AAAPARr-në janë hapur edhe tri qendra të reja në tri shkollat partnere të AAAPARr-së.



AnnaKontny, koordinatorë për arsim profesional në GIZ, ka folur për objektivat dhe aktivitetet që ka ndërmarrë GIZ-i për arsimin dhe aftësimin profesional. Kurse Armend Bajraktari, drejtor i Qendrës së Kompetencës, ka folur rreth trajnimeve afatshkurtra modulare për muratorë dhe instalues elektrikëqë kjo qendër po synon të realizoj.

SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

1.1. Qeverisja dhe legjislacioni

1.1.1. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Burimeve Njerëzore

- Vlerësimet vjetore për menxhmentin e shkollave partnere të AAAPARr-së për vitin 2018;
- Përgatitja dhe procedimi i ndryshimeve të muajit për Listën e pagave për stafin e shkollave partnere sipas kërkesave të shkollave partnere;
- Përgatitja e planit të personelit sipas kërkesave të MAP për vitin 2019;
- Përgatitja e planit për vitin 2019 për trajnimin e stafit të AAAPARr-së nga IKAP;
- Kërkesat drejtuar MASHT-it për avancimin dhe zhvillimin e uebfaqes së AAAPARr-së në dy gjuhët zyrtare;
- Kërkesa për hapjen e profilit të ri sipas kërkesës së QeK-Prizren;
- Takime me menaxhmentin e shkollave partnere për çështje të personelit;
- Përgatitja e lëndëve për auditim nga Auditori i Përgjithshëm;
- Procedimi i kërkesave për vendime për pushime të lehonisë dhe pensionim të stafit të shkollave partnere;
- Përgatitja e rekomandimeve për Auditorin e Brendshëm;
- Shpallja e ftesës për ofertë për organizimin e ekskursionit të maturantëve të ShMLP “11 Mars” - Prizrendhe QendresëKompetencës - Malishevë, si dhe përzgjedhja e kompanisë;
- Shkresa njoftuese për Ministrinë e Financave dhe Inspektorit të Punëslidhur me pagesat e pensionistëve të cilat dotë ekzekutohen me përmbarues dhe tjetjerat të vazhdojnë me gjykatë;
- Takim me menaxhmentin e shkollave partnere të Agjencisë së AAAPARr-së lidhur me çështjet e administratës dhe financave;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve lidhur me angazhimin e ekspertëve për hartimin e udhëzuesve dhe materialeve mësimore;
- Pranimi i ndryshimeve për listën e pagave;
- Shkresa për Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me kërkesat për lejimin dhe buxhetimin e disa kategorive ekonomike;
- Përgatitja e KASH-it për vitin 2020/2022;
- Përgatitja e shkresës për kryetarin e Komisionit për Administratë Publike;
- Shkresa drejtuar Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë;
- Shpallja e konkursit sipas kërkesave të Menaxhmentit të QendresëKompetencës në Prizren dhe ShMM “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë;
- Përgatitja dhe dërgimi i shkresave për Ministrinë e Administratës Publike;
- Procedimi i pagesave për arsimin e tërriturve si dhe kërkesa për rritjen e kufijve për këtë kategori buxhetore;

- Organizimi i ekskursionit për maturantët e ShMLT “11 Marsi” në Prizren, përgatitja dhe shpallja e ofertës në gazetën ditore, formimi i komisionit përzgjedhës për hapjen e ofertës, përzgjedhja e kompanisë, dhënia e pëlqimit për realizimin e ekskursionit;
- Përgatitja dhe zhvillimi i procedurave për rekrutimin e mësimitdhënësve për zëvendësimin e orëve të lira në Qendrën e Kompetencës në Prizren, shpallja e konkursit, formimi i komisionit përzgjedhës, testimi i kandidatëve dhe përzgjedhja;
- Takim me ekipin e Auditorëve të Brendshëm lidhur me auditimin e Agjencisë;
- Plotësimi i pyetësorit të kontrollit të brendshëm;
- Përgatitja e dosjes sipas kërkesës së Auditorit lidhur me kronologjinë e themelimit të Agjencisë, Organogramin e AAPARr-së, planifikimin e buxhetit, të hyrat vetjake dhe raportin e shpenzimit;
- Përgatitja e lëndëve për Auditorin e Brendshëm, përfshirë lëndët që kanë të bëjnë me personelin e Agjencisë dhe shkollave partnere;
- Përgatitja e planit të personelit për vitin 2019 pas miratimit të buxhetit sipas kërkesës së MAP për dërgim në MAP;
- Kërkesa drejtuar Ministrisë së Financave për lirimin e 39 normave të mësimitdhënësve të ShMM “Ymer Prizrenit” të cilët gjenden në listën e pagave të Agjencisë;
- Përgatitja dhe zhvillimi i procedurave të rekrutimit për angazhim të ekspertëve për hartimin e udhëzuesve (doracakëve) për shkollat partnere të Agjencisë;
- Përgatitja e statistikave për vlerësimet e performancës së stafit të Agjencisë dhe shkollave partnere për vitin 2018 për dërgim në MAP;
- Vizita në QeK Prizren me rastin e dyerve të hapura të organizuar nga shkolla;
- Përgatitja e dosjes me të dhëna të kërkuara për Auditorin e Jashtëm;
- Finalizimi i marrëveshjes me Lux-Dev;
- Procedimi i vendimeve për pushim të lehonisë, vendimet për pensionime dhe vendimet e tjera;
- Shpallja e konkursit për regjistrim të nxënësve për vitin e ri shkollor 2019/2020;
- Shpallja e konkursit për mësimitdhënës për shkollat për vitin e ri shkollor 2019/2020 si dhe zhvillimi i procedurave;
- Përgatitja e ftesës për ofertë për ekskursion të maturantëve të Shkollës së Mesme të Makinerisë “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, QeK Skenderaj, QeK Prizren, QeK Ferizaj në Republikën e Shqipërisë;
- Publikimi i konkursit për regjistrim të nxënësve për nivelin V;
- Konkursi për regjistrimin e nxënësve për mësimin për të rritur në ShMLP “Shtjefën Gjeçovi”- Prishtinë për vitin shkollor 2019/2020;
- Të dhënat për raportin e performancës së AAPARr-së për dërgim në MASHT;
- Përgatitja e kontratave të reja për stafin e shkollave partnere;
- Vendimet për emërim të anëtarëve të komisionit për rekrutim të kandidatëve për mësimitdhënës;
- Përgatitja e shkresës për largim të normave të ShME “Ymer Prizreni” në Prizren;
- Shpallja e konkursit për mësimitdhënës të nivelit V.

1.1.2. Aktivitetet e realizuara në Zyrën e Financave

- Përgatitja e lëndëve për Agjencinë e AAAPARr-së;
- Paraqitja e obligimeve të mbetura nga viti 2018;
- Përgatitja e planifikimit të prokurimit për vitin 2019 në bazë të Ligjit të Buxhetit 2019;
- Buxheti i shpërndarë për Agjencinë dhe shkollat në menaxhim në bazë të Ligjit të Buxhetit 2019;
- Nënaloqimi i buxhetit për muajin janar, 1/12 pjesë ebuxhetit të vitit 2018;
- Regjistrimi i shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në tabelat për barazim;
- Shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për marrjene qasjeve të përdoruesve në SIMFK të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari kryesor administrativ;
- Përgatitja e raportit lidhur me numrin e punëtorëve sipas listës së pagave me orar të plotë dhe të shkurtuar të Agjencisë dhe shkollave nën menaxhim dhe dërgimi i saj te zyrtarët kompetentë në MAShT;
- Përgatitja e raportit lidhur me barazimin e shpenzimeve të pranimit të mallit, barazimi i shpenzimeve në mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale e të tjera dhe dërgimi i tij në MAShT;
- Përgatitja e deklaratës së disponueshmërisë së fondeve për mirëmbajtjen e shkollave, të nënshkruar dhe vulosur nga zyrtari kryesor administrativ;
- Nënshkrimi dhe dërgimi i PCF2 në MAShT për vitin 2019;
- Ndarja dhe dërgimi i tabelës së plotësuar për ndarjen e mjeteve të të hyrave vetjake në kategorinë Paga dhe mëditje sipas buxhetit të ndarë për vitin 2019;
- Përgatitja e planit të rrjedhjes së parasë për vitin 2019;
- Tabela e regjistrimit të pasurisë për vitin 2018;
- Zotimi dhe tërheqja e Pety Cash-it për Agjencinë dhe shkollat;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2020-2022 dhe dërgimi i saj te zyrtarët kompetentë në MAShT;
- Menaxhimi i listës së pagave për çdo muaj;
- Analizamujore e buxhetit në kategorinë Paga dhe Mëditje;
- Kërkesat e pranuar nga shkollat dhe dërgimi i tyre te zyrtarët kompetentë;
- Takim me administratorët e shkollave lidhur me çështjet financiare;
- Deklarimi i tatimit në burim dhe kontributeve për ekspertët me kontratë të marrëveshjeve për shërbime të veçanta për çdo muaj;
- Gjetja, përgatitja dhe dërgimi i lëndëve të kërkuara dhe fotokopjimi i tyre tek auditori i brendshëm në MAShT;
- Nënaloqimi i mjeteve të tremujorit të dytë të Agjencisë dhe qendrave të kompetencës për kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime Komunale;
- Përgatitja e të dhënave të të punësuarve për muajin mars dhe dërgimi te personat kompetentë;
- Dërgimi i tabelës për grumbullimin e të hyrave vetjake dhe dërgimi te zyrtari i të hyrave në MAShT;

- Gjetja dhe dërgimi i lëndëve të kërkuara të obligimeve të vitit 2018 tek Auditori i Brendshëm;
- Barazimi i shpenzimeve të buxhetit të Agjencisë dhe shkollave nën menaxhimpër periudhën janar-qershor 2019;
- Marrja pjesë në takimin e mbajtur në MASHT lidhur me rekomandimet e Auditorit Gjeneral;
- Bërja e nënalokimit për shkollat speciale për kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime Komunale;
- Kthim ikomenteve lidhur me draftraportin e auditimit të njësia e Auditimit të Brendshëm;
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2019;
- Përgatitja e planifikimit të buxhetit për vitet 2020-2022 për Agjencinë dhe Qendrat e Kompetencës;
- Analiza e kategorisë ekonomike në paga dhe mëditje për muajt janar-qershor 2019;
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2019;
- Pranimi i Qarkores së Dytë Buxhetore 02/2019 si dhe planifikimi i buxhetit;
- Përgatitja e minusit për paga si analiza janar-dhjetor për minusin në paga;
- Përgatitja e planifikimit të buxhetit për vitin 2020-2022 për Agjencinë dhe qendrat e kompetencës;
- Analiza e kategorisë ekonomike nëpaga dhe mëditje për muajt janar-qershor 2019;
- Përpilimi i kërkesave për buxhet shtesë për mbulimin e shpenzimeve për fundvit për 6 (gjashtë) qendrat e kompetencës;
- Shpenzimi i lëndëve të shkollave dhe Agjencisë;
- Dërgimi i e-malit shkollave për përfundimin e vitit fiskal, njoftimi për afatet e zotimeve, mbyllja e petycash-eve, shpenzimeve;
- Dërgimi i rregullores dhe kërkesa për paraqitjen e obligimeve për fundvit;
- Nënalokimi i mjeteve për gjashtëqendrat e kompetencave për tremujorin e fundit;
- Përgatitja dhe dërgimi i performancës për vitin 2018 për Agjencinë dhe Qendrat e Kompetencave.